



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT I SHKURTËR

Nga procesverbali i mbledhjes së 17-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 05.09.2023, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Zoran Cirkovic, anëtar
7. Sllavisa Trajkovic

Të tjerë prezent

1. Brahim Duriqi, DKA
2. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
3. Përfaqësues të OSBE-së,
4. Përfaqësues të Unmikut
5. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 15-të dhe 16-të
2. Informatë nga DKA-ja, për fillimin e vitit të ri shkollor.
3. Të ndryshme

Pastaj tha po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 15 dhe 16-te të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstrakteve nga mbledhja 15 dhe 16-te të e Komitetit për Komunitete?

Informatë nga DKA-ja, për fillimin e vitit të ri shkollor.

Skendr Bikliqi, kryesues i komitetit tha se ne emër te komitetit kam vërejtje për ekzekutivin pasi qe nuk janë serioz sa here qe po i thërrasim për ndonjë informate ne komitet nuk po marrin pjesë.

Edhe pse erdh me vonese zyrtari nga Arsimi po ia kaloj fjalën Brahim Duriqit, nga drejtorati për Arsim, i cili në pika të shkurta i njoftoi, rreth Informatës..

Pastaj Kryesuesi e hapsi diskutimin?

Skender Bikliqi, tha se a ka filluar me kohë procesi mësimor dhe a kemi rënjë të numrit të nxënësve ne shkolla po njëjtë.

Gentianë Hoxhaj, sa është numri i nxënësve te regjistruar ne klasën e parë dhe sa nxënës janë ne një klasë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se sa i përket dy shkollave te qytetit asaj “Vëllezërit Frashëri” dhe “Ismail Luma” në Lipjan ne atë “Vëllezërit Frashëri” është numri i stërngarkuar i nxënësve dhe per kete DKA-ja, duhet te ketë kriteret me te forta qe mos te vijnë nxësit nga fshatrat te regjistrohen ne këtë shkollë. E dyta, kalimi i nxënësve te kësaj shkolle te shkolla “Adem Gllavica” ka sjellë pakënaqësi te prindërit a jeni në dijeni ju DKA-ja Dhe e fundit, kjo shkollë edhe pse ka filluar procesi mësimor një klase është pa mësuese, pse nuk është bërë rekrutimi me kohë. Po ashtu edhe çështja e librave ka ndikuar keq te prindërit dhe nxënësit dhe kjo është tmerruese. A është afatgjatë apo afatshkurtër shkuarja e nxënësve ne atë shkollë.

Shahadije Bikliqi, tha se pse duhet me mbet nxënësit pa mësues ne shkollën “Vëllezërit Frashëri” pse nuk është marr me kohë mësimdhënësi pse duhet ata nxënës te jeni pa mësim qe disa ditë. Në cilat shkolla nuk ka filluar procesi mësimor.

Brahim Duriqi, tha se po ka filluar procesi mësimor ne te gjitha shkollat përveç ne babush, qe nuk ka filluar për shkak te dëmtimit te shkollës nga fatkeqësitë natyrore. Nuk kemi mujt me zëvendësua atë mësimdhënësi pasi qe ajo nuk ka bërë kërkesë për pushim. Sa i përket vendimit për transferim te nxënësve nga “Vëllezërit Frashëri” te “Adem Gllavica” është vendim i DKA-së.

Zoran Cirkovioc, tha se sa i përket shkollës “Vëllezërit Aksiq” në Lipjan se bashku me dy paralelet e ndara, procesi mësimor ka filluar me kohë dhe janë bërë te gjitha përgatitjet. Ne si shkollë punojmë me plan program te Serbisë. Ndërsa sa i përket materiali hargjues, lëndëve djegëje për ngrohje ato na furnizon DKA-ja. E kemi një shqetësim si shkollë në Grackë ku një grua vjen i ushqen disa qenë në oborrin e shkollë dhe kjo po na shqetëson shumë. Për këtë e kemi lajmëruar edhe stacionin policor në Lipjan. Numri i nxënësve është i njet qysh ka qenë edhe më herët.

III

Të ndryshme

Skender Bikliqi, tha se ju njoftoj qe Ana Gucic me nuk do te jetë anëtare e komitetit për komitete pasi qe është shpërngul në Kroaci.

E dyta ne kemi bërë disa vizita në teren duke vizituar te gjitha komitetet , muajin e ardhshëm presim qe te dalim ne Grackë nëse pajtoheni ju si anëtar.

Zoran Cirkovic, tha se pari e kam një shqetësim për ta ngritur ka të bëjë me uzurpimin e pronës publike nga disa persona të cilët po i blejnë pronat private. Dhe ne kur po kemi ndonjë festë nuk po na lejohet parkimi i veturave ne pronën publike nga këta individ. Kërkoj nga personat përgjegjës te komunës se Lipjanit qe te merren me këtë çështje. Po ashtu kërkoj qe te behet edhe vendosja e pengesave ne fshatin Grackë te Banesat kolektive pasi qe aty po vozitët me shpejtësi te madhe dhe po rrezikohet ata banorë. Ndërsa sa i përket vizitës ne teren në Grackë nuk ka nevojë po qe doni mund te shkojmë ne Rubovc.

Skender Bikliqi, tha se ne e kemi vizituar te gjitha komunitetet ndërsa ne Garcke dhe Rubovc nuk jemi kane eshët mire qe edhe ato vende ti vizitojmë.

Zoran Cirkovic, tha se ne shkolle ne Gracke nuk na pranojnë me vizituar ndërsa rrugicat e fshatit mund ti vizitojmë.

Lulzim Qerimi tha se edhe unë do ta ngris një shqetësim ku komunitetet qe banojnë ne Lipjan kanë aplikuar ne MAPL për ndërtimin e shtëpive mirëpo asnjë nuk ka përfituar nga komuna e Lipjanit dhe kjo shihet qe është bere kryesisht për çështje politike. Kur dihet qe këta banorë kanë kanë nevojë shumë për banim e sidomos komuniteti ashkali.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne Lipjan komunitetet kanë nevojë shumë për banim, e sidomos ai në Gadime dhe ju si nënkryetar keni thënë qe ju janë përmirësuar kushtet, tani po thoni qe kushtet i akne jo te mira.

Lulzim Qerimi, tha se komuniteti ashkali me krahasua me vitet e kaluara i kane tani kushtet me te mira, por këtu janë refuzuar për shkak te qeshtjeve politike.

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht votoi.

Meqë çështje të tjera nuk pati vizita përfundoi në ora 15³⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi